

EPPC Albania kërkon një **Drejtor të Departamentit të Marketingut dhe PR** për klientin e saj, një ndër kompanitë më të mëdha e të konsoliduara në vend dhe rajon.

NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM:

Kandidati ideal është përgjegjës/e për planifikimin, zhvillimin dhe implementimin e strategjive të marketingut, komunikimit të këtyre strategjive dhe aktiviteteve të marrëdhënieve me publikun të kompanisë.

Përgjegjësitë Kryesore:

1. Përgjegjës për misionin, objektivat financiare të dep. Marketing/Komunikim/PR;
2. Harton plane afatgjata/afatshkurtra dhe plan buxhete për vazhdueshmërinë e programit të dep. të marketing, komunikim dhe marrëdhënie me publikun, monitoron progresin, siguron vazhdimësinë e punës dhe vlerëson performancën e këtij departamenti;
3. Harton, implementon dhe monitoron sisteme dhe procedura të nevojshme për lehtësimin e punës në departamentin që drejton;
4. Harton, implementon dhe vlerëson strategji të marketingut dhe një program të marrëdhënieve me publikun me qëllim promovimin e imazhit të kompanisë në treg dhe mes konkurrentësh;
5. Koordinon marrëdhëniet me mediat, mban marrëdhënie të mira dhe kontakte të rregullta me to duke iu përgjigjur kërkesave të tyre nëpërmjet materialeve informative në lidhje me kompaninë;
6. Përfaqëson në media të gjithë aktivitetin që kompania ushtron, nëpërmjet deklaratave për shtyp dhe cdo komunikimi për median;
7. Përgjegjës për drejtimin e punëve editoriale, dizejm, prodhim dhe shpërndarje të publikimeve të kompanisë;
8. Mbështet me konsulencë dhe ekspertizë të gjitha aktivitetet e departamentit.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare në Marketing/Marrëdhënie me Publikun/Komunikim;
- **Përvojë e mëparshme pune jo më pak se 5 vjetare në pozicione drejtuese në Marketing/PR/Komunikim;**
- Aftësi të shkëlqyera ndërpersonale dhe komunikimi përfshirë: të folurit në publik, të shkruarit;
- Aftësi të shkëlqyera vendimmarrje, organizimi dhe menaxhimit të kohës
- **Të zotërojë shkëlqyeshëm gjuhën Angleze**, MS Office dhe të jetë familjar me median dhe hapësirën dixhitale.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail^{it}:

tianda.nano@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.
Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.